

VENDIM
Nr. 719, datë 28.8.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË FINANCIVE, SI AUTORITET KONTRAKTOR, PËR
KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR DISA PROJEKTE TË
MINISTRISË SË FINANCIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013” dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik me fondet e miratuara në buxhetin e këtij viti, përkatësisht për:

- a) “Blerje servera, *storage* për sistemet e Ministrisë së Financave”;
- b) “Shërbim konsulence për sistemin e Thesarit”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha